



VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 5 qershor 2026

Lënda nr. 2025-03

Agim Zeka dhe Derjana Zeka

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (në vijim: Paneli), i mbledhur më 5 qershor 2026, në përbërje të anëtarëve të mëposhtëm:

Znj. Marina MANCINI, ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit
Z. Petko PETKOV, anëtar

i asistuar nga:
Znj. Pia HOLM, zyrtare ligjore

pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP, të datës 4 shkurt 2008, Konceptin e Llogaridhënies të EULEX-it, të datës 29 tetor 2009, për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregulloren e Punës së Panelit, të ndryshuar për herë të fundit më 2 qershor 2026,

pas shqyrtimit të çështjes, vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa është parashtruar përmes postës elektronike dhe është regjistruar me datë 13 nëntor 2025.
2. Me shkresën e datës 14 nëntor 2025, Paneli njoftoi Shefin e Milionit të EULEX-it në Kosovë (në vijim: Misioni) se ankesa ishte regjistruar.
3. Me datë 19 nëntor 2025, Paneli kërkoi nga parashtruesit e ankesës informacione shtesë lidhur me dokumentet e renditura në ankesë, të cilat nuk ishin bashkëngjitur.

4. Po atë ditë, parashtruesit e ankesës dorëzuan përmes postës elektronike versionin e rishikuar të ankesës, i cili nuk ishte i nënshkruar, duke bashkëngjitur dokumentet përkatëse.
5. Me datë 21 nëntor 2025, pas kërkesës së Panelit, parashtruesit e ankesës dorëzuan versionin e rishikuar dhe të nënshkruar të ankesës.

II. FAKTET

6. Parashtrues të ankesës janë Agim Zeka dhe vajza e tij, Derjana Zeka. Ata janë shqiptarë të Kosovës dhe banojnë në Mitrovicën e Veriut.
7. Parashtruesit e ankesës pretendojnë se, më 16 shkurt 2024, kishin shkuar në Qendrën e EULEX-it në Mitrovicë për të paraqitur një ankesë lidhur me praktika të pretenduara të paligjshme të rekrutimit në Policinë e Kosovës, por se hyrja në objekt iu ishte mohuar nga personeli i sigurisë.
8. Ata pretendojnë se aplikimet e Derjana Zekës për pozita në Policinë e Kosovës janë refuzuar në mënyrë të kundërligjshme në tri raste. Në dy raste, asaj i ishte sugjeruar që të deklarohej si boshnjake për të pasur sukses në procedurën e aplikimit. Herën e tretë, asaj iu tha se aplikimi i saj nuk mund të pranohej, pasi diploma e saj e shkollës së mesme, e lëshuar nga autoritetet e Republikës së Serbisë, nuk njihet në Kosovë.
9. Parashtruesit e ankesës pretendojnë se, pasi iu ishte mohuar hyrja në Qendrën e EULEX-it në Mitrovicë, ia kishin paraqitur rastin EULEX-it përmes postës elektronike, por nuk kishin marrë asnjë përgjigje nga Misioni.

III. ANKESA

10. Parashtruesit e ankesës pretendojnë se, si rezultat i veprimeve të përshkruara më sipër, janë cenuar të drejtat e tyre të garantuara me instrumentet ndërkombëtare të mëposhtme të të drejtave të njeriut, pa specifikuar më tej natyrën e shkeljeve të pretenduara.
 - Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
 - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
 - Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
 - Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
 - Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave;
 - Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese.

IV. LIGJI

11. Para se të shqyrtojë ankesën në themel, Paneli duhet të përcaktojë nëse ankesa është e pranueshme, duke marrë parasysh Rregullin 29(1) të Rregullores së Procedurës. Kjo dispozitë parashikon që Paneli mund ta shpallë një ankesë të papranueshme në procedurë të përsheptuar, ndër të tjera, nëse ankesa bie jashtë juridiksionit të Panelit.
12. Në përputhje me rregullin 25(1) të Rregullores së Punës, juridiksioni i Panelit është i kufizuar në ankesat që kanë të bëjnë me shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut nga Misioni gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Mandati ekzekutiv i Misionit përcaktohet në nenin 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit të BE-së 2008/124/CFSP, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të BE-së (CFSP) 2018/856.
13. Paneli vlerëson se EULEX-i në Kosovë nuk ka asnjë kompetencë lidhur me rekrutimin e personelit në Policinë e Kosovës. Hetimi dhe ndjekja penale e praktikave të pretenduara të paligjshme në procesin e rekrutimit në Policinë e Kosovës bien tërësisht në kompetencën e autoriteteve të Kosovës.
14. Paneli konstaton se pretendimet e paraqitura nga parashtresit e ankesës nuk kanë të bëjnë me ushtrimin e mandatit ekzekutiv të Misionit dhe, rrjedhimisht, bien jashtë juridiksionit të Panelit.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri, konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar ankesën, pasi ajo bie jashtë juridiksionit të tij në kuptim të Rregullave 25(1) dhe 29(1)(d) të Rregullores së Procedurës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Marina MANCINI,
Ushtruese e Detyrës së Kryesueses



Petko PETKOV,
Anëtar